



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 307, datë 29.12.2020

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË MAGJISTRATIT ZNJ.
LINDITA ZIGURI (MALE), KANDIDAT PËR T'U KOMANDUAR INSPEKTOR
PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 159, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neneve 32, 35 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, Rregullores “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “ Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të magjistratit, kandidat për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Lindita Ziguri (Male)”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Lindita Ziguri (Male), sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror, znj. Lindita Ziguri (Male) dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Lindita Ziguri (Male).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI


ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA



**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**




**ANËTAR
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKAJ**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

